Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ me cilësinë \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj se kam në proçes dhe/ose jam shpallur fitues për kontratat e



mëposhtme:

Nr.	Autoriteti kontraktor	Objekti i procedurës së prokurimi/kontratës	Vlera e shpallur fituese

**Data e dorëzimit të deklaratës** \_\_\_\_\_

**Përfaqësuesi i ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**Vula**

**Shënim:** Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të plotësojë këtë deklaratë.

## **Shtojca 12**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor* ]

### **1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

**Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.**

**Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.**

**Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.**

**Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:**

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*
- b. *Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1;*
- c. *Sigurim oferte, (nëse është e zbatueshme) sipas Shtojcës 3;*
- ç. *Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;*
- d. *Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;*
- dh. *Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës Shtojcës 8/1;*
- e. *Formular vlerësimi sipas Shtojcës 9;*
- f. *Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 10;*
- g. *Deklarate mbi kontratat e lidhura apo ne proces, sipas Shtojcës 11;*
- gj. *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

### **2.1. Per kapacitetin ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:**

I percaktuar ne kushtet e pergjithshme te kualifikimit

### **2.2. Per kapacitetin ekonomik dhe financiar:**

## Dokumenta Standarde të Tenderit

1. Kopje të çertifikuara të balanceve të tre viteve të fundit ushtrimore (2017, 2018, 2019), të paraqitur në autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave, të konfirmuara nga ky autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar.
2. Xhiro mesatare vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit ushtrimore (2017, 2018, 2019), lëshuar nga autoriteti përkatës, vlera mesatare e se ciles duhet të jete jo me vogel se 50 % të vlerës limit të kontratës që prokurohet.
3. Nje dokument qe verteton se ka plotesuar detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore ku ka ushtruar dhe ushtron aktivitetet per vitin 2018 dhe 2019; Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin e lëshuar nga njesia vendore në të cilën ka vendushttrim aktiviteti sipas QKB.

### 2.3 Per kapacitetin teknik:

#### 1. Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

- a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet pa TVSH, të realizuar gjatë tri viteve të fundit.
- b) Punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit është në një vlerë sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet pa TVSH.

Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

- Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:
  - **Deklaratën sipas shtojcës Nr. 9 (Formulari i vleresimit), shoqëruar me:**
  - **Kontrate;**
  - **Situacionin përfundimtar;**
  - **Aktin e kolaudimit,**
  - **Çertifikaten e marrjes ne dorezim**
  - **Fatura tatimore per cdo situacion punimesh.**
- Ne rastin e pervojës se meparshme te realizuar me sektorin privat, Operatori ekonomik duhet te paraqese dokumentacionin e meposhtem:
  - Kontrate;
  - Reference/vertetim punimesh nga Investitori,
  - Situacionin përfundimtar;
  - Akt kolaudimi;
  - Fatura tatimore per cdo situacion punimesh.

#### 2. Licënsa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

## Dokumenta Standarde të Tenderit

Liçenca e shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhte:

### PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

- N.P - 1 - A *Punime gjurmimi në tokë.*
- N.P - 4 - B *Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale.*
- N.P - 5 - A *Punime nëntoksore, ura e vepra arti*
- N.P - 7 - D *Ujësjetës, gazsjellës, vajsjetës, vepra kullimi e vaditje.*
- N.P - 12 - B *Punime të inxhinierisë së mjedisit.*

### PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

- N.S. - 1 – A *Punime për prishjen e ndërtimeve*
- N.S -9 - A *Punime strukturore speciale.*
- N.S -18- B *Punime topogjeodezike.*

sipas modelit të lëshuar nga MPPT;

3. Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt të përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në marrëdhënie pune në subjekte të tjera publike apo private, në kontrata të tjera, si dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin Kontrate Pune, Diplome.
4. Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të ketë një punësim mesatar i të paktën 110 (njqind e dhjetë) personave, për periudhën Janar 2019 - Korrik 2020 të vërtetuar me;
  - a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, për periudhën Janar 2019 - Korrik 2020.
  - b) Listepagesat e punonjesve sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për periudhën Janar 2019 - Korrik 2020, të konfirmuara nga organet përkatëse.
5. Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë Drejtues teknik që të figurojnë në licencën e shoqërisë dhe në listepagesa.
  - Inxhinier Ndërtimi (1)
  - Inxhinier Hidroteknik (1)
  - Inxhinier Mjedisit (1)
  - Inxhinier Gjeolog/Gjeoteknik (1)
  - Inxhinier Topograf/Gjeodet (1)

Sa me sipër duhet të paraqesë kontratë pune të vlefshme (noteriale), diplomë, CV, libereze pune, si dhe të jenë në listepagesa të paktën 2 vjetërin e fundit.

6. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë certifikatë cilësie në gjuhën shqipe, ose përkthyerë dhe të noterizuar për fushë veprimtarite: “NDERTIMIN DHE RIKONSTRUKSIONIN E UJESJELLESAVE”, si më poshtë:
  - ISO 9001:2015” ( Sistemi i menaxhimit të cilësisë);
  - BS OHSAS 18001 / 45001:2007/2018 (Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në

## Dokumenta Standarde të Tenderit

*punë).*

- *ISO 14001:2015 (Sistemi i menaxhimit të mjedisit) ;*
- *PAS 99:2012” (Sistemi i menaxhimit të integruar) ;*
- *ISO 39001:2012” (Certifikate për sistemin e menaxhimit të sigurisë në trafikun rrugor);*
- *ISO 50001:2011 (Sistemi i menaxhimit të energjisë) ;*
- *SA 8000:2014 (Sistemi i menaxhimit të përgjegjësisë shoqërore);*
- *EN-ISO 3834-2:2006. ); (Sistemi i cilësisë për saldimin e materialeve metalike)*

7. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar me kohë të plote si më poshtë:

- Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar 1 (nje) Inxhinier Hidroteknik, me kontratë pune lidhur pranë noterit, diplomë, të jetë në listepagesa të pakten 2 vjeçar in e fundit.
- Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar 1 (nje) Inxhinier Mekatronik për makinerite/pajisjet elektromekanike që do të angazhohen, me kontratë pune lidhur pranë noterit, diplomë, dëshmi sigurimi teknik ISHTI-IQT, të jetë në listepagesa të pakten 2 vjeçar in e fundit.
- Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të pakten 1 (nje) Mjek, me Kontratë pune lidhur pranë noterit, Licence nga Urdheri i Mjekut, diplomë, të jetë në listepagesa të pakten 6 muajt e fundit.
- Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të pakten 8 (tete) Manovratore të paisur me Leje/dëshmi perkatese (leje manovrimi), si dhe 10 (dhjete) drejtues automjetesh (shoferë) , me kontratë pune si dhe të figurojnë në listepagesat e shoqërisë 6 muajt e fundit.
- Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të pakten 2 (dy) Teknik të mesëm ndertimi kontratë pune, diplomë, të pajisur me dëshmi sigurimi teknik nga ISHTI-IQT ose Ekuivalente si dhe të jenë në listepagesa të pakten 2 vjeçar in e fundit.
- Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë në stafin e tij minimalisht 1 (nje) Inxhinier ndertimi, dhe 25 punonjës/specialiste të pajisur me dëshmi sigurimi teknik nga ISHTI-IQT ose Ekuivalente.
- Operatori Ekonomik ofertues duhet që të ketë në stafin e tij minimalisht 1 (nje) Inxhinier Hidroteknik drejtues teknik, i cili të jetë i Certifikuar për Sigurim në Kantier si dhe i Certifikuar për ”*Sigurimin dhe kontrollin e cilësisë sipas ISO 9001:2015*”. Për këtë operatori ekonomik duhet të dorëzojë: *Certifikatë “Kordinator i Sigurimit në Kantier”, ”Sigurimin dhe kontrollin e cilësisë sipas ISO 9001:2015”, Diplome, Kontratë pune të figurojë në listepagesa 2 vjeçar in e fundit.*
- Operatori ekonomik duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar të pakten 2 (dy) punonjës, të certifikuar për punime në *skarpatë (lartësi)*, si dhe të jenë në Listepagesa të të pakten *12 muajt e fundit.*
- Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë në stafin e tij minimalisht 1 (nje) Ekspert zjarrfikës me kontratë pune noteriale dhe lejen perkatese, i cili të figurojë në listepagesa të pakten 2 vjeçar in e fundit.
- Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë në stafin e tij minimalisht 4 (kater) Hidraulik me kontratë pune dhe dëshmi/certifikatë perkatese, si dhe të figurojnë në listepagesa të pakten 12 muajt e fundit.

## Dokumenta Standarde të Tenderit

- Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet te kete ne stafin e tij minimalisht 2 (dy) Specialist Montues Tuba me kontrate pune dhe deshmi/certifikate perkatese, si dhe te figurojne ne listepagesa te pakten 12 muajt e fundit.
- Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet te kete ne stafin e tij minimalisht 2 (dy) Saldator me kontrate pune dhe deshmi/certifikate perkatese, si dhe te figurojne ne listepagesa te pakten 12 muajt e fundit

### 8. Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion ( shtojca 10).

<u>Mjetet</u>	<u>Sasia</u>	<u>Gjendja</u>
Kamion kapacitet mbajtës mbi 18 ton	8 cope	Pronësi ose me qera
Kamionçinë me kapacitet mbajtës (1-2.5 ton)	4 cope	Pronësi ose me qera
Kamionçinë me kapacitet mbajtës (3-4 ton)	4 cope	Pronësi ose me qera
Kamion me vinc	2 cope	Pronësi ose me qera
Eskavatore me zinxhire	2 cope	Pronësi ose me qera
Eskavator me goma	1 cope	Pronësi ose me qera
Buldozer	2 cope	Pronësi ose me qera
Minieskavatore	6 cope	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	5 cope	Pronësi ose me qera
Autopompe betoni	2 cope	Pronësi ose me qera
Rrul Gome – Gome per Asphalt mbi 14 ton	1 cope	Pronësi ose me qera
Rrul Hekur – Hekur mbi 10 ton	1 cope	Pronësi ose me qera
Rrul Vibrues Gome – Hekur mbi 18 ton	1 cope	Pronësi ose me qera
Rrul me Kompresor dhe Vibrim min.10 ton	1 cope	Pronësi ose me qera
Autobitumatrice	2 cope	Pronësi ose me qera
Asfaltoshtruese	2 cope	Pronësi ose me qera
Autobot uji kapacitet mbajtës min. 5000 litra	1 cope	Pronësi ose me qera
Autovinc kapacitet min. 10 ton	1 cope	Pronësi ose me qera
Grejder	3 cope	Pronësi ose me qera
Paisje topografike GPS	2 cope	Pronësi ose me qera
Nivelues lazer	2 cope	Pronësi ose me qera
Aparat saldimi tuba plastik	2 cope	Pronësi ose me qera
Gazogjen	1 cope	Pronësi ose me qera
Motosaldatrice	2 cope	Pronësi ose me qera
Matrapik	2 cope	Pronësi ose me qera
Batipal	1 cope	Pronësi ose me qera
Kompresor	2 cope	Pronësi ose me qera
Ngrites Pirun	2 cope	Pronësi ose me qera
Tokmak	3 cope	Pronësi ose me qera
Vibrator	3 cope	Pronësi ose me qera
Vibrator Hidraulik Shpues Thellesie	1 cope	Pronësi ose me qera
<b>Sondë për shpime,mikrotunele horizontale</b>	1 cope	Pronësi ose me qera
Prerese dhe kthyesa hekuri	1 cope	Pronësi ose me qera
Vinc kollon minimumi 10 ton	2 cope	Pronësi ose me qera
Vinc kollon min. 1 ton, lartesi 30 ml	2 cope	Pronësi ose me qera

## Dokumenta Standarde të Tenderit

Motobetoniere kapacitet min. 0.5m3	2 cope	Pronësi ose me qera
Karro dore	40 cope	Pronësi ose me qera
Fikse zjarri	5 cope	Pronësi ose me qera
Kuti te ndihmes se shpejte	5 cope	Pronësi ose me qera
Gjenerator te pakten 50 Kw	5 cope	Pronësi ose me qera
Semafore sinjalistike per punime rrugore	1 cope	Pronësi ose me qera
Tabela sinjalistike sigurimi teknik	50 cope	Pronësi ose me qera
Projektor	5 cope	Pronësi ose me qera
Rimorkiator - Terheqes	3 cope	Pronësi ose me qera
Rimorkio per transportin e makinerive	3 cope	Pronësi ose me qera

- Per mjetet e transportit duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (te vlefshme), foto te mjeteve, dhe per mjetet e siguruar me qera, dokumentat e mesiperme duhet te shoqerohen me kontraten perkatese te qerese, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi. Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
  - Per paisjet dhe mjetet e tjera fatura tatimore te blerjes ose deklarata doganore.
  - Për mjetet e transportit për mallrat të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, (*Autobitumatrice*) duhet të paraqesin çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet perkatese (e vlefshme).
  - Operatori ekonomik duhet te deklaroje vendodhjen e sakte te mjeteve te deklarurara me qellim verifikimi ne cdo kohe prej Autoritetit Kontraktor. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga përfaqesuesi i shoqërisë ofertuese).  
*Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikoje vertetesine e deklarates. Ne rast deklarimi te rreme do te veprohet ne perputhje me nenin 13, pika 3, germa "a" te Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, "Per Prokurimin Publik".*
  - Operatori/et ekonomik ofertues duhet të deklaroje që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara më sipër të Kapacitetit Teknik do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontrate. Autoriteti Kontraktor gëzon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmërinë e këtyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës.
9. Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet te disponojne ose te kene te garantuar furnizimin



e asfaltit:

**Fabrik Asfalti me QKL ne Pronesi / kontrate noteriale qeraje / kontrate noteriale furnizimi.**

Per sa mesiper duhet te paraqesin dokumentacionin e pronesise apo marrjes me qera, apo kontrate noteriale furnizimi, te shoqeruar me leje mjedisore te leshuar nga QKL si me poshte:

QKL - Fabrike asfalti – Leje Mjedisi tipi B, Kodi:III.1.B., si dhe e pajisur me ISO 9001:2015, mbi çertifikimin e cilësisë së asfaltit nga prodhuesi, si dhe te shoqerohet me Raport Monitorimi nga Organe te akredituara prane Drejtorise se Pergjithshme te Akreditimit te pakten 6 muajt e fundit nga data e zhvillimit te tenderit.

Mbështetur në kërkesat e STASH 660-87 dhe STASH 561-87, duke ditur se përgatitja e asfaltit realizohet në temperaturën 155 °C deri në 170 °C, Fabrika/Impianti i prodhimit të Asfaltit duhet të jetë në një distancë jo më të largët **se 40 km** nga vendndodhja e objektit të prokurimit. Kjo për arsye që të sigurohet se temperatura e domosdoshme për ngjeshjen e asfaltit **jo më pak se 140 °C**, kusht teknik për ngjeshje referuar dhe V.K.M. Nr. 628, date 15.07.2015.

**10. Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet te disponojne ose te kene te garantuar furnizimin e betonit:**

**Fabrike/impiant betoni ne pronesi / kontrate noteriale qeraje/kontrate noteriale furnizimi.**

Per sa mesiper duhet te paraqesin dokumentacionin e pronesise apo marrjes me qera, apo kontrate noteriale furnizimi, te shoqeruar me leje mjedisore te leshuar nga QKL si me poshte:

QKL- Fabrike/impiant Betoni – Leje Mjedisi tipi B, Kodi:III.1.B., si dhe e pajisur me ISO 9001:2015, mbi çertifikimin e cilësisë së betonit nga prodhuesi, si dhe te shoqerohet me Raport Monitorimi nga organe te akredituara prane Drejtorise se Pergjithshme te Akreditimit te pakten 6 muajt e fundit nga data e zhvillimit te tenderit.

**11. Nyje Inertesh me QKL ne Pronesi / kontrate noteriale qeraje / kontrate noteriale furnizimi.** QKL – Leje Mjedisi te tipit C, Kodi: III.1.A “Per prerje, gdhendje guri”, Raport Monitorimi nga organe te akredituara prane Drejtorise se Pergjithshme te Akreditimit te pakten 6 muajt e fundit nga data e zhvillimit te tenderit.

**12. Operatori ekonomik ofertues apo bashkimi i operatoreve ekonomike per materialet si me poshte: :**

*Tub PE 100 Φ 315 mm, PN 10 atm;*

*Tub PE 100 Φ 200 mm, PN 10 atm*

*Tub PE 100 Φ 160 mm, PN 10 atm*

*Tub PE 100 Φ 125 mm PN 10 atm*

*Tub PE 100 Φ 110 mm PN 10 atm*

*Tub PE 100 Φ 90 mm PN 10 atm*

*Tub PE 100 Φ 75 mm PN 10 atm*

*Tub PE 100 Φ 63 mm PN 10 atm*

*PE 100 Φ 50 mm PN 10 atm*

*Tub PE 100 Φ 40 mm PN 16 atm*

*Saraçineskë flutur DN 300 mm, Pn 16 bar*

*Pjese Çmontuese DN 300 mm, Pn 16 bar*

*Fllanxhë adaptor për tub PE DN 315 mm, Pn 16 bar*

*Tub çeliku DN/OD 168.3/5 mm l = 200 mm*

## Dokumenta Standarde të Tenderit

*Fllanxhë çeliku DN 150 mm, Pn 16 bar*  
*Saraçineskë DN 150 mm, Pn 16 bar*  
*Pjese Çmontuese DN 150 mm, Pn 16 bar*  
*Fllanxhë adaptor për tub PE DN 160 mm, Pn 16 bar*  
*Tub çeliku DN/OD 168.3/5 mm l = 200 mm*  
*Fllanxhë çeliku DN 150 mm, Pn 16 bar*  
*Saraçineskë DN 150 mm, Pn 16 bar*  
*Pjese Çmontuese DN 150 mm, Pn 16 bar*  
*Fllanxhë adaptor për tub PE DN 160 mm, Pn 16 bar*  
*Fllanxhë adaptor për tub HDPE me saldim DN 315 mm, Pn 16 bar*  
*Tee DN 300 x 125 x 300 mm Pn 16 bar*  
*Pjese Çmontuese DN 300 mm, Pn 16 bar*  
*Saraçineskë DN 125 mm, Pn 16 bar*  
*Pjese Çmontuese DN 125 mm, Pn 16 bar*  
*Fllanxhë adaptor për tub HDPE me saldim DN 125 mm, Pn 16 bar*  
*Tee DN 300 x 200 x 300 mm Pn 16 bar*  
*Saraçineskë DN 200 mm, Pn 16 bar*  
*Pjese Çmontuese DN 200 mm, Pn 16 bar*  
*Fllanxhë adaptor për tub HDPE me saldim DN 200 mm, Pn 16 bar*  
*Fllanxhë adaptor për tub HDPE me saldim DN 125 mm, Pn 16 bar*  
*Tee DN 125 mm Pn 16 bar*  
*Pjese Çmontuese DN 125 mm, Pn 16 bar*  
*Saraçineskë DN 125 mm, Pn 16 bar*  
*Reduksion DN 125 / 100 mm Pn 16 bar*  
*Fllanxhë adaptor për tub HDPE me saldim DN 110 mm, Pn 16 bar*  
*Ajrues 90° bronxi me dy veprime 1/2"*  
*Xhundo PPR ( 1 1/2" 1/2"-50/ 20 mm) x 1/2"(fileto bronxi femer)*  
*Tuba e PPR Pn 16 f = 50 mm Ø*  
*Xhundo ovale PPR ( 1 1/2" 3/4"-50/ 25 mm) x 3/4"(fileto bronxi femer)*  
*Saraçineskë me sferë me magnet 3/4"F-F*  
*Saraçineskë kundravalvul flutur Ø 3/4"F-M*  
*Nipples 3/4 "*  
*Brryle PPR Dn25 mm x 3/4"(fileto femer)*  
*Brryle PPR Dn25 mm me ngjitje*  
*Saraçineskë me flutur sferë 1 1/2"F-F PN10*  
*Adaptor EF Dn50 x 1 1/2"M Hdpe,Pn10*  
*Brryl EF Dn50 mm PE,Pn10*  
*Kundravalvul 3/4"Pn 16 bar*  
*Mates uji multijet 3/4 "EN14154*  
*Tub PE 100 Pn 10 bar DN 25 mm per lidhje me konsumatore*  
*Rakorderi flanxhë për tub HDPE me filet DN 50 mm Pn 16 at*

### **Duhet te paraqese:**

- Kontrate/Marreveshje noteriale furnizimi te lidhur me Prodhues ose Distributor te Autorizuar nga prodhuesi, per materialet e listuara mesiper me volumet e kerkuara nga Autoriteti Kontraktor ne preventivin e tenderit.

## Dokumenta Standarde të Tenderit

- Prodhuesi i materialeve duhet të plotësojë standardet ISO 9001:2015, Operatori ofertues duhet të paraqese çertifikaten përkatëse.
  - Operatori Ofertues duhet të paraqese kontrate/marreveshje noteriale furnizimi me prodhuesin, për materialet e listuara mesipër me volumet e kerkuara nga Autoriteti Kontraktor në preventivin e tenderit, adresën e saktë dhe kontakte si: telefon, fax, e-mail.
  - Në rastet kur Kontrata/marreveshja lidhet me distributor të autorizuar, kontrata/marreveshja noteriale e furnizimit për materialet e listuara mesipër me volumet e kerkuara nga Autoriteti Kontraktor në preventivin e tenderit, duhet të shoqërohet me Autorizimin e distributorit nga prodhuesi ku të përkrahë saktë prodhuesi adresë dhe kontakte si: telefon, fax, e-mail.
  - Kontrata e furnizimit duhet të përkrahë garantimin e materialeve përgjatë gjithë afatit të zbatimit të objektit të prokurimit.
- 13.** Operatori/et ekonomike ofertues duhet të jetë i pajisur me licence nga Qendra Kombëtare e Licensimit (QKB) Kodi III.2. B “*Transport i mbetjeve nga ndërtimet*”.
- 14.** Cdo ofertues do të paraqese edhe **Grafikun i Punimeve** në përputhje me afatin e realizimit të punimeve të kerkuar.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

### Shtojca 13

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)*

#### **PROJEKTI I ZBATIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE**

**Përshkrimi i të dhënave teknike të punëve objekt prokurimi** të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

#### **KUJDES**

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyruesisht në këto specifikime.

Skicimet, Planimetritë e Objektivit etj:

## Dokumenta Standarde të Tenderit

Specifikimet Teknike të Materialeve:

Grafiku i Punimeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

**Shtojca 14**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)*

**PREVENTIVAT E PUNIMEVE**

**Shtojca 15**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor* ]

**NJOFTIM STANDART PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR<sup>1</sup>**

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar Z. /Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 Për Prokurimin Publik.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

---

---

---

---

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt

< **Emri** >

**Shtojca 16**

[ Shtojcë për t'u plotësuar Autoriteti Kontraktor]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

[Data \_\_\_\_\_]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it

Vlera \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

2. \_\_\_\_\_  
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it

Vlera \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. \_\_\_\_\_  
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it

2. \_\_\_\_\_  
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [\_\_\_\_\_] është identifikuar si oferta e

## Dokumenta Standarde të Tenderit

suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

[Titullari i autoritetit kontraktor]



[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR**

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_

\* \* \*

Procedura e prokurimit: \_\_\_\_\_

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

- |                                 |                        |
|---------------------------------|------------------------|
| 1. _____                        | _____                  |
| <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | <i>numri i NIPT-it</i> |

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

- |                                 |                        |
|---------------------------------|------------------------|
| 2. _____                        | _____                  |
| <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | <i>numri i NIPT-it</i> |

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

- |                                 |                        |
|---------------------------------|------------------------|
| 1. _____                        | _____                  |
| <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | <i>numri i NIPT-it</i> |
| 2. _____                        | _____                  |
| <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | <i>numri i NIPT-it</i> |

Dokumenta Standarde të Tenderit

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

---

---

---

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_ *numri i NIPT-it* \_\_\_\_\_

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_ / Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_ *numri i NIPT-it* \_\_\_\_\_

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_ / Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

Etj. \_\_

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*], brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_  
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

**[Titullari i autoritetit kontraktor]**

## Shtojca 18

### **KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS Punët – Procedura e Hapur**

#### **Neni 1: Qëllimi**

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Punëve të prokuruarra ne bazë të legjislacionit të prokurimit.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

#### **Neni 2: Përkufizime**

- 2.1 “Preventiv total” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotesuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.
- 2.2 “Preventiv per njesi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.
- 2.3 “Afati i realizimit te punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikun për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokurues.
- 2.4 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në

## Dokumenta Standarde të Tenderit

referimin e çdo dokumenti.

- 2.5 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.6 “Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.
- 2.7 “Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.
- 2.8 “Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.
- 2.9 “Data e fillimit” është përfshirë në Të dhënat e kontrates. Ajo është data kur kontraktori do të fillojë punimet e ndertimit. Nëse kjo nuk realizohet, “data e fillimit” do të jetë dita në të cilën do të paguhet paradhenia.
- 2.10 “Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.
- 2.11 “Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 2.12 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.13 “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.14 “Drejtues projekti” do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.
- 2.15 “Autoritet Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe që kontraktori punon objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.16 “Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- 2.17 “Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.
- 2.18 “Nënkontraktues” do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- 2.19 “Kontraktor” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.
- 2.20 “Standarte Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe

shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

- 2.21 “Ngritja e kantierit” do të thotë punimet e ndertimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluara, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndërtimit.
- 2.22 “Punime” do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të përkufizuara në dokumentat e tenderit.

### **Neni 3: Hartimi i Kontratës**

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

### **Neni 4: Praktikrat e Korrupuara, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve**

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korrupuara. Veprimet e korrupuara përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në pregatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktori duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

### **Neni 5: Informacioni Konfidencial**

- 5.1 Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktori mund t’i japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar që nënkontraktorin të zbatojë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premtun ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

### **Neni 6: Prona Intelektuale**

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t’i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t’i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t’i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si

hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.

- 6.3 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

#### **Neni 7: Origjina e Materialeve**

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.
- 7.3 Për qëllime verifikimi “origjinë” do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e kontraktorit ose nënkontraktorit që furnizon me materiale.

#### **Neni 8: Vendimet e Drejtuesit të Projektit**

- 8.1 Drejtuesi i projektit do të vendosë për çështjet e kontratës midis kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor
- 8.2 Drejtuesi i Projektit mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët përveç zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Drejtuesi i projektit duhet të njoftojë kontraktorin për delegimet e bëra apo të revokuara.

#### **Neni 9: Komunikimi**

- 9.1 Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

#### **Neni 10: Bashkëpunimi në Kantier me të Tjerët**

- 10.1 Kontraktori duhet të bashkëpunojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera, autoritete publike, shërbimet publike dhe Autoritetin Kontraktor siç kërkohet dhe përkufizohet në Grafikonin e realizimit të punimeve.

**Neni 11: Përgjegjësia e Autoritetit Kontraktor**

- 11.1 Autoriteti Kontraktor ka përgjegjësi të kompensojë kontraktorin për dëmtime të pajisjeve të kontraktorit deri në masën që lidhet me veprime me faj të Autoritetit Kontraktor ose të projekteve të Autoritetit Kontraktor me perjashtim të rastit kur keto të fundit, kishin gabime të dukshme që mund të ishin konstatuar lehtësisht nga kontraktuesi.

**Neni 12: Raporti i Inspektimit të Kantierit dhe Kushtet e Kantierit**

- 12.1 Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për konkluzionet ose interpretimet e bëra në raportin e inspektimit të kantierit.
- 12.2 Kontraktori pranon se i ka marrë të gjitha hapat e nevojshme për të verifikuar natyrën dhe vendin e Punimeve dhe se ka inspektuar dhe pajtohet me kushtet e përgjithshme dhe lokale që mund të ndikojnë në kryerjen ose koston e Punëve.

**Neni 13: Kontraktori që Kryen Punimet**

- 13.1 Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë Punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit.
- 13.2 Kontraktori nuk mban përgjegjësi për gabimet në projekt, të dhëna, planimetri ose aspekte të tjera të specifikimeve teknike, të dhëna nga Autoriteti Kontraktor, me përjashtim të rasteve kur gabimi ishte aq i dukshëm sa kontraktori duhet ta kishte vënë re dhe ta kishte reklamuar këtë të Autoriteti Kontraktor.
- 13.3 Kodet dhe standartet që do zbatohen do të jenë të shprehura në dokumentat e tenderit. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në zbatimin e kodeve ose standarteve, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pasi të jenë aprovuar nga Autoriteti Kontraktor.

**Neni 14: Ekzekutimi i Punimeve**

- 14.1 Kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë sapo ta lidhe atë dhe duhet t'i mbarojë Punët brenda Afatit të Mbarimit.

**Neni 15: Ngritja e Kantierit**

- 15.1 Kontraktori mban përgjegjësi për projektin e Ngritjes së Kantierit.
- 15.2 Kontraktori duhet të paraqesë të gjitha planet për Ngritjen e Kantierit tek drejtuesi i projektit për shqyrtimin dhe miratimin e tij.

**Neni 16: Sigurimi Teknik dhe Mjedisor**

- 16.1 Kontraktori do të mbajë përgjegjësi për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në kantier.
- 16.2 Kontraktori do të sigurojë kantierin në mënyrë të tillë që të minimizojë dëmtimet e mjedisit. Për shembull, ai duhet të kursejë energjinë, ujin dhe burime të tjera, të reduktojë humbjen dhe të minimizojë përdorimin e substancave varfëruese të ozonit, çlirimin e gazrave, Lëndët

